



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

NR. 43, DATË 31 / 03 / 2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT PREJ 926 ,449,664 LEKË TË PËRFITUAR NË
FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR NGA FONDI I
RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2021**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.189, datë 25.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Tiranë, Durrës dhe Vorë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 25.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkitë Durrës dhe Kavajë”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 926,449,664 lekë të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit për vitin 2021, i detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

VKM që ka miratuar fondin	Gr	Kap	Programi	Llog. ekon	Kodi i produkt	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
VKM nr.189, datë 25.03.2021	00	1	04960	606	94902AB	Rikonstruksion i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë , të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilave janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por	860,700,000

VKM nr.205, datë 25.03.2021	00	1	04960	606	94902AC	Financimi i rindërtimit të 22 banesave individuale për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit , banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.	65,749,664
						TOTALI	926,449,664

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi





SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Dorina Milja

*dhe paosi dhe me muqese?
Almerida Rosh*



U shpall sot më datë 01.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. ~~247~~ / prot.
11.



Durrës, më 07/04/2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 43 datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit prej 926,449,664 lekë të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit të vitit 2021”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

